



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. 1725 Prot.

Tiranë, më 03.05.2024

**Lënda:** Kërkesë për mbledhjen e Komisionit dhe zhvillimin e një seance dëgjimore.

**Drejtuar:** **Znj. Klotilda BUSHKA**  
Kryetare e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

**Këtu**

Znj. Kryetare,

Në datën 16 prill 2024, Shkolla e Magjistraturës ka publikuar listën e konkurrentëve të kualifikuar për të marrë pjesë në fazën e parë të provimit të pranimit në profilin gjyqtar, prokuror dhe ndihmës ligjor për programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2024 – 2025.<sup>1</sup> Sipas kësaj liste, numri total i konkurrentëve të kualifikuar ishte 442 persona.

Në fazën e parë të provimit të zhvilluar në datën 22 prill 2024, kanë marrë pjesë 411 konkurrentë. Sipas informacionit të përcjellë nga konkurrentë të ndryshëm, rezulton se për shkak se disa konkurrentë kanë kërkuar të dalin nga salla për arsye personale, teza fillestare e provimit është ndryshuar nga Drejtori i Shkollës. Provimi ka zgjatur 2 (dy) orë e 30 (tridhjetë) minuta. Në përfundim të provimit, konkurrentët kanë dorëzuar fletët e plotësuar për vlerësim.

Nga të dhënat e shfaqura elektronikisht nga pajisja scantron ka rezultuar se vetëm 79 konkurrentë kishin marrë më shumë se 60% të pikëve, cka do të thotë se vetëm ky numër kualifikohej për fazën e dytë të provimit. Megjithatë, Drejtori i Shkollës ka konstatuar se numri i fituesve ishte shumë i ulët dhe se pajisja scantron ka lexuar vetëm 96 nga 100 përgjigje të tezës së provimit. Në deklaratën publike të Shkollës thuhet se kishte pretendime edhe nga një pjesë e konkurrentëve të pranishëm në sallë lidhur pasaktësi të rezultatit.<sup>2</sup>

Në këto kushte, Drejtori i Shkollës i ka vënë në dispozicion Komisionit të Vlerësimit një pajisje të re, e cila pasi ka kryer rivlerësimin e të gjithave tezave të provimit, ka arritur në përfundimin se numri i konkurrentëve që kalonte pragun e 60% të pikëve ishte 121 (njëqind e njëzet e një) konkurrentë ose 42 konkurrentë të kualifikuar më shumë se vlerësimi i parë. Këto fakte rezultojnë

<sup>1</sup> <https://magjistratura.edu.al/sq/lajme/njoftime/lista-e-konkurrenteve-te-kualifikuar-per-te-marre-pjese-ne-provimin-e-pranim-it-2024-2025>

<sup>2</sup> <https://magjistratura.edu.al/sq/lajme/njoftime/deklarate-per-media-24.04.2024>

të jenë të pranuar nga vetë Drejtori i Shkollës së Magjistraturës, gjatë mbledhjes së Këshillit Drejtues në datën 24 prill 2024.<sup>3</sup>

Megjithatë, sërish duke iu referuar faqes zyrtare të Shkollës së Magjistraturës rezulton se në datën 23 prill 2024 është shpallur lista e konkurrentëve të kualifikuar për fazën e dytë të provimit. Në total numri i konkurrentëve është 121.<sup>4</sup> Ndërsa, në listën përfundimtare të konkurrentëve të kualifikuar për të marrë pjesë në fazën e dytë të publikuar nga Shkolla në datën 24 prill 2024, rezulton se listës së mësipërme t'i jenë shtuar edhe 10 konkurrentë të tjerë, duke e çuar numrin total të konkurrentëve të kualifikuar në 131.<sup>5</sup> Sa i përket kësaj shtese të dytë mungon një sqarim publik në faqen zyrtare të Shkollës së Magjistraturës.

Kjo situatë e pazakontë në raport me vitet e mëparshme ka ngritur pikëpyetje serioze në opinionin publik sa i përket rregullshmërisë dhe integritetit të këtij procesi. Administrimi i rregullt dhe korrekt i provimit për pranimin në Shkollën e Magjistraturës të kandidatëve për gjyqtarë, prokurorë dhe ndihmës ligjor është garanci për pavarësinë dhe integritetin e sistemit të drejtësisë në të ardhmen. Kuvendi, dhe vecanërisht Komisioni i Ligjeve, ka detyrimin të mos qëndrojë indiferent ndaj një shqetësimi publik që ngre dyshime mbi procesin dhe rrezikon besueshmërinë e sistemit të drejtësisë për të paktën 30 vitet e ardhshme.

Në këto kushte, në cilësinë e anëtarëve të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbështetje të nenit 32, pika 2, dhe nenit 36, pika 1, të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, kërkojmë mbledhjen e Komisionit në seancë dëgjimore me Drejtorin dhe Këshillin Drejtues të Shkollës së Magjistraturës në datën 8 maj 2024, ora 10:00, për të dhënë shpjegime dhe informacione lidhur me zhvillimin e provimit të pranimit për programin e formimit fillestar për vitin akademik 2024 – 2025.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

#### DEPUTETËT

Ilirida Supri  
Cecilia

Gazment Bosku

Donatona Supri

<sup>3</sup> <https://magjistratura.edu.al/sq/lajme/njoftime/njoftim-mbi-zhvillimin-e-mbledhjes-se-keshillit-drejtues-te-shkolles-se-magjistratures>

<sup>4</sup> <https://magjistratura.edu.al/sq/lajme/njoftime/lista-fituese-scantron-2024-25>

<sup>5</sup> <https://magjistratura.edu.al/sq/lajme/njoftime/njoftim-mbi-listen-perfundimtare-te-konkurrenteve-te-kualifikuar-per-te-marre-pjesen-ne-fazen-e-dyte>

Saima Zaidi

Aslan Aggarwal

Cerd Bylykova (Cerd)

ERISA Xixho

Elda Hoti

Greta Bendel

Jinlita Metaling (Jinlita)

Melissa Vachani

Ishqiptaria.com